

STATUTI DHE AKT THEMELIMI

I SHOQERISE TREGETARE “FIBER LINE” shpk

KREU I

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 1

Sot me date 08/11/2025 sipas kerkesave te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite trgetare” dhe te ligjit nr.9723 date 03.05.2007”Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit,i perditesuar krijohet shoqeria tregtare “**FIBER LINE**” Shpk, e cila do te veproje ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi, nenet e ketij statuti si dhe aktit bashkengjitur tij.

KREU II

EMRI, STATUTI, SELIA, KOHEZGJATJA

NENI 2

Formohet shoqeria tregtare e emertuar “ **FIBER LINE**” shpk me themelues;

- **Zj. Desada Bardhi i datelindjes 24-07-1998, lindur ne Tirane, dhe banus ne Tirane.**

- NENI 3

Shoqeria do te kete statusin e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar dhe do te perballoje humbje deri ne kufirin e kontributit te themeluesit te saj ne kapitalin themeltar.

NENI 4

- **Selia e shoqerise tregtare private “FIBER LINE” shpk, do te jete ne adresen:**
- **Rruga “Aleksandri i Madh”, godina nr 55, Kati I, Kashar, Astir, Tirane**
- Ajo mund te cele dhe seli te tjera te dyta, dege e filiale, perfaqesi dhe agjensi operative ne te gjithe territorin e R.SH. dhe me miratim te organeve kompetente edhe jashte vendit.

NENI 5

Shoqeria do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj pa afat.

NENI 6

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtje “ **FIBER LINE**” sh.p.k.

KREU III

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

NENI 7

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte si me poshte:

- Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj ne fushen e:

Sherbime interneti, suport per klientet, instalime fibrash optike, sisteme kamerash sigurie, sisteme alarmi dhe sherbime te tjera te lidhura, etj.

KAPITALI

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 leke,dhe zoterohet si me poshte:

- Zj. Desada Bardhi zoteron 100% te kuotave me vlere nominale 100,000 leke kouta.

Kapitali eshte ne vlere 100,000 leke e ndare ne 1 kuote, vlere e te cilit eshte 100,000 leke.

Kuotat e kapitalit themeltar jane te nenshkrueshme dhe te shlyeshme krejtesisht. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 9

Kapitali i shoqerise mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimeve te asamblese se ortakut te vetem, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e kapitalit themeltar.

NENI 10

Ortakët mund t'u shesin te treteve kuotat e tyre te kapitalit pjeserisht ose teresisht, por pasi tua kene ofruar per blerje ortakut brenda shoqerise me kushte jo me pak te favorshme nga ato qe j'u ofrohen te treteve. Oferta i komunikohet me shkrim ortakut te cilet kane te drejten e parablerjes, e drejte qe duhet ta ushtrojne brenda 30 diteve nga data e komunikimit.

NENI 11

Kapitali shoqerise do te perbehet nga kapitali themeltar, mjetet e xhiros dhe te tjera te nevojshme te luejteshme e te paluejteshme per ushtimin e aktivitetit te shoqerise.

NENI 12

Heqja dore nga shoqeria nuk e liron ortakun nga detyrimet e lindura me pare ndaj shoqerise. Gjithashtu ai gezon te gjitha te drejtat e lindura para largimit te tij.

KREU IV

ORGANET DREJTUESE

NENI 13

Organet drejtuese te shoqerise do te jene :

- **Ortaket:**

1- Desada Bardhi nr ID J85724069G

Fusha e veprimit, perberja dhe menyra e funksionimit e organeve drejtuese rregullohet si me poshte:

ASAMBLEJA

NENI 14

Asambleja e ortakeve eshte organi me i larte vendimor. Ajo mblidhet sa here e shohin te arsyeshme ortaket, por domosdoshmerisht per te miratuar bilancin vjetor te shoqerise. Asambleja i merr vendimet e ortakeve , pervec rasteve te parashikuara ne statut.

NENI 15

Asambleja vendos per bilancin vjetor, per ndryshimet ne statut, shtimin ose pakesimin e kapitalit, per emerimin e organit administrativ, per drejtimet kryesore te veprimtarise se shoqerise, per pushimin apo rritjen e veprimtarise se shoqerise.

ORGANI ADMINISTRATIV

NENI 16

Administrator i shoqerise FIBER LINE Shpk do te jete :

- **Zj. Desada BARDHI** datelindjes 24-07-1998 me Nr ID **J85724069G** me afat **5 vjecar.**

NENI 17

Administratori ka te drejte te perfaqesoje shoqerine ne mardhenie me te tretet per permbushjen e aktivitetit te saj ne perputhje me nenin 6 te ketij statuti.



Organi Administrativ është kompetent për :

- të miratuar planet dhe bilanci periodikë mujorë dhe tre mujorë;
- propozuar strukturën e aparatit të shoqërisë;
- marrë në punë persona të ndryshëm dhe rregullimin e marrëdhënieve të punës me ta;
- propozon rregullimin, krijimin dhe destinimin e fondeve të ndryshme (të vecanta), ndarjen e fitimit, etj. ;
- përfaqësuar apo emëruar përfaqësues në kështjë gjyqësore që mund të ketë shoqëria;
- përfaqësuar shoqërinë në regjistrin e pronës sipas nenit 20 të këtij statuti.

KREU V

KUSHTET EKONOMIKE

NENI 18

Shoqëria është pronare, përdoruese dhe disponuese e pasurisë së saj. Ajo vepron në regjistrin e pronës si çdo person tjetër juridik në Shqipëri, mund të blejë, të shesë, të japë në përdorim, të ngarkojë me barë për detyrime ndaj të tjerëve ose për kredi bankare, etj.

NENI 19

Shoqëria ka llogarinë e saj rrjedhëse, si dhe librin e saj të llogarive në bazë të kërkesave të ligjit për kontabilitetin e dispozitave të tjera fiskale. Transferimi i mjeteve monetare dhe transaksionet financiare do të kryhen në bazë të kritereve të caktuara nga Banka e Shqipërisë.

NENI 20

Veprimet ekonomiko-financiare të shoqërisë nisën vitin e parë në momentin e regjistrimit në organet tatimore, ndërsa vitet tjera në Janar dhe mbyllen në 31 Dhjetor të çdo viti. Në çdo fund periudhe ushtrimore hartohet bilanci kontabel sipas ligjeve në fuqi brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës nxirret bilanci. Bilancet periodikë (mujorë, tremujorë e gjashtëmujorë) miratohen e nënshkruhen nga Administratori e më pas ratifikohen në asamblenë e radhës. Bilancet vjetorë miratohen nga asambleja dhe nënshkruhen nga administratoret.

NENI 21

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria i mbetet në përdorim ortakut të vetëm në kapitalin themeltar të shoqërisë, mbasi të jenë likuiduar të gjitha detyrimet e të jetë hequr fondi i rezervës ligjore, sipas vendimeve të asamblese.

KREU VI
MAREDHENIET E PUNES
NENI 22

Mardheniet e punes ne kete shoqeri rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per ceshtjet qe nuk parashikohen ne to zbatohen dispozitat e Kodit te Punes ne R.Sh. Mosmarveshjet e punonjesve me shoqerine do te zgjidhen ne gjykatën shqiptare. Punonjesit e emeruar nuk marrin pjese ne ndarjen e fitimit te realizuar nga shoqeria gjate aktivitetit te saj , nese ne kontrate nuk eshte parashikuar ndryshe. Per punen e kryer punonjesit marrin page sic eshte parashikuar ne kontrate.

KREU VII
NENI 23

Veprimtaria e shoqerise pushon me vendim te asamblese per shkaqet:

- veprimtaria rezulton negative
- pamundesi veprimi
- shperndahet me vullnetin e ortakut te vetem
- riorganizohet ne nje forme tjeter

NENI 24

Ne kushtet e nenit 23 te ketij statuti asambleja cakton nje ose me shume likujdatore te cilet marrin ne dore drejtimin e shoqerise duke kryer gjithë veprimet e likujdimit te saj, duke likujduar ne radhe te pare detyrimet ndaj shtetit e me pas ndaj te treteve. Ne rastin e teprices se kapitalit te shoqerise me perfundimin e likuidimit, kjo i shperndahet ortakut, ndersa ne rastin e pamjaftueshmerise se kapitalit ortakut eshte i detyruar te derdhi kuotat e tyre deri ne nivelin e kuotave te kapitalit themeltar.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

NENI 25

Shoqeria konsiderohet e krijuar ne perputhje me nenet e ketij statuti dhe aktit bashkelidhur dhe fiton personalitetin juridik me regjistrimin ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit ne Tirane.

NENI 26

Per sa nuk eshte shprehur ne kete statut i referohet plotesimeve qe do te beje asambleja si dhe ligjeve te vecanta ne te cilat eshte referuar hartimi i ketij statuti. Ndryshimet dhe plotesimet e ketij statuti behen ne te njejten menyre e procedure me te cilen nxiret vete statuti.

NENI 27

Ky statut u perpilua ne prani te ortakut duke shprehur vullnetin e tij te lire. Ai u perpilua ne kater kopje me fuqi te barabarte secila per t'u depozituar ne Qendren Kombetare te Biznesit Tirane, ne zyren e Tatim -Taksave dhe nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise.

O R T A K E T

E

THEMELIMIT TE SHOQERISE “ FIBER LINE” shpk

DESADA BARDHI

